



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 4.6.2024

Nr: 10

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 6, DATË 22.5.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI "PARTIA ARDHMËRIA SHQIPTARE"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 4.6.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Ardhmëria Shqiptare

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 38, datë 09.04.2024 "Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja "b", 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 4.6.2024 Nr: 10
Ora: 10:30



"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 6, datë 22.5.2024 të depozituar nga subjekti 'Partia Ardhmëria Shqiptare'"

VËREN:

Subjekti “Partia Ardhmëria Shqiptare”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 06 regj., datë 22.5.2024.

Në mbledhjen e datës 4.6.2024, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 6, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 6, datë 22.5.2024, të paraqitur nga subjekti “Partia Ardhmëria Shqiptare”.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet bashkërisht me kërkesën ankimore nr. 5, në seancën e datës 11.06.2024, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	Lako	-	Anëtar
Elvis	Çefa	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar